



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**VENDIM**

**K.P.P. 126/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.03.2019, shqyrtoi ankesat me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Bean” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt, “Ndërtim shkollë 9 vjeçare Qerret”, me nr. REF-95528-11-23-2018, me fond limit 74,344,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Bean” sh.p.k  
*Adresa: Lagjia “Qendër”, pranë shkollës 8-vjeçare, Levan, Fier.*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës  
*Adresa: Sheshi “LIRIA”, Durrës.*

**Baza Ligjore:** *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 26.11.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt, “Ndërtim shkolla 9 vjeçare Qerret”, me nr. REF-95528-11-23-2018, me fond limit 74,344,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2 Në datën 07.01.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 23.01.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Ina” & ”Al-Asfalt” shpk	46,476,925 lekë, Skualifikuar;
2. ”Rajli Ndërtim” & ”Varaku-E” shpk	47,461,636 lekë, Skualifikuar;
3. “Bean” shpk	49,178,761 lekë, Skualifikuar;
4. “K.M.K” & ”Sinder AB” & ”Alb Konstruksion” & ”Eral Construction Company” shpk	49,436,233 lekë, Skualifikuar;
5. “Inerti” shpk	50,709,899 lekë, Skualifikuar;
6. “Kacdedja” & ”Agri Construction” shpk	51,993,060 lekë, Skualifikuar;
7. “Kevin Konstruksion” shpk	52,757,168 lekë, Skualifikuar;
8. “Beqiri” & ”Sardo” shpk	52,813,848 lekë, Skualifikuar;
9. “Ndregjoni” shpk	53,440,756 lekë, Skualifikuar;
10. “Eurondërtimi 2000” shpk	54,363,412 lekë, Skualifikuar;

11. "Caushi" shpk	55,543,858 lekë, Skualifikuar;
12. "Boshnjaku B" & "5 Vëllezërit" shpk	58,782,645 lekë, Skualifikuar;
13. "HTM" & "BE-IS" shpk	59,011,000 lekë, Skualifikuar;
14. "Liqeni VII" & "Pe-Vla-Ku" shpk	60,603,689 lekë, Skualifikuar;
15. "Leon Konstruksion" shpk	61,702,361 lekë, Skualifikuar;
16. "Curri" shpk	65,386,261 lekë, Skualifikuar;
17. "Pepa Group" & "Junik" shpk	67,854,795 lekë, Skualifikuar;

II.4. Në datën 14.02.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Ina" & "Al-Asfalt" shpk	46,476,925 lekë, Skualifikuar;
2. "Rajli Ndërtim" & "Varaku-E" shpk	47,461,636 lekë, Kualifikuar;
3. "Bean" shpk	49,178,761 lekë, Skualifikuar;
4. "K.M.K" & "Sinder AB" & "Alb Konstruksion" & "Eral Construction Company" shpk	49,436,233 lekë, Skualifikuar;
5. "Inerti" shpk	50,709,899 lekë, Skualifikuar;
6. "Kacdedja" & "Agri Construction" shpk	51,993,060 lekë, Skualifikuar;
7. "Kevin Konstruksion" shpk	52,757,168 lekë, Skualifikuar;
8. "Beqiri" & "Sardo" shpk	52,813,848 lekë, Skualifikuar;
9. "Ndregjoni" shpk	53,440,756 lekë, Skualifikuar;
10. "Eurondërtimi 2000" shpk	54,363,412 lekë, Skualifikuar;
11. "Caushi" shpk	55,543,858 lekë, Skualifikuar;
12. "Boshnjaku B" & "5 Vëllezërit" shpk	58,782,645 lekë, Skualifikuar;
13. "HTM" & "BE-IS" shpk	59,011,000 lekë, Skualifikuar;
14. "Liqeni VII" & "Pe-Vla-Ku" shpk	60,603,689 lekë, Skualifikuar;
15. "Leon Konstruksion" shpk	61,702,361 lekë, Skualifikuar;
16. "Curri" shpk	65,386,261 lekë, Skualifikuar;
17. "Pepa Group" & "Junik" shpk	67,854,795 lekë, Skualifikuar;

II.5. Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik "Bean" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*"1. Në DST Shtojca 12, pika 2.3 "Për kapacitetin teknik", ne germen l është kerkuar: List pagesat sipas formulareve standarte për sigurimet, për gjashtë muajt e fundit me kohë të plotë pune që i takojnë pagesat me datën e hapjes së ofertës, ku numëri i punonjësve të jetë minimumi 63 persona (përfshirë dhe numrin e punonjësve të stafit sipas pikës "h") Dokumenta të konfirmuara nga institucioni përkatës sipas legjislacionit ne fuqi (nëpërmjet formës elektronike). Duke iu referuar list pagesave të paraqitura nga operatori ekonomik BEAN, KVO konstaton se, nuk janë me kohë të plotë pune: Mjeku Br. B., punonjesit e Stafit mbështetës të shoqërisë si: Punëtori e specializuar me makineri manovratorë. Punëtori e specializuar në ndërtim; elektrikist, karpentier hekurthyes, saldator, hidraulik, murator, pllakashtrues, bojaxhi.*

*2. Në DST Shtojca 12, pika 2.3 "Për kapacitetin teknik", ne germen k është kerkuar si poshtë: Kerkohet certifikate ISO 9001:2015 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara me poshtë: Kaldaja do të jetë çeliku me kapacitet jo më të vogël se 93kv dhe me dimensione jo më të vogla se*

710x1294x1758mm, dalja e oxhakut jo më vogël se Ø 220mm. Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit. Operatori ekonomik BEAN për produktin e sipercituar, ka paraqitur një “Kontrat Furnizimi” të datës 28.12.2018, të lidhur midis tij dhe furnizuesit “AL-NOBEL” shpk, me seli në Tiranë, ku ky i fundit me cilesinë e distributorit të kompanisë TERMOSTAHL SOLAR LTD, deklaroi se merr persiper të furnizoje me produktin e sipercituar operatorin ekonomik por, mungon certifikata ISO 9001:2015 e prodhuesit për cilësinë e produkteve. Për arsye të sa më sipër u citua, KVO vendos që operatori ekonomik BEAN të mos kualifikohet, pasi nuk përmbush kriteret për kualifikim, të kërkuara në dokumentat e tenderit.”

II.6. Në datën 29.01.2019 operatori ekonomik “Bean” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]1. Në lidhje me arsyen se: Listpagesa që është dorëzuar nga operatori “BEAN” shpk nuk është me kohë të plotë pune mjeku B. B. dhe punonjesit e stafit mbështetës të shoqërisë. ju sqarojmë se: Operatori Ekonomik “BEAN” sh.p.k., punonjesit e vet i ka siguruar në listëpagesë me ditë pune sipas procesit të punës dhe kohëzgjatjes që ata kryejnë. Nëse një punonjës nuk është siguruar 22 ditë pune, por më pak se aq, kjo do të thotë që ky specialist kaq ditë ka patur procesin e ngarkuar të punës. Këta punonjës janë pjesë e shoqërive dhe të disponueshëm në çdo kohë ku ka procese pune për të cilat ata janë të kualifikuar. Mjeku është me kontratë të rregullt dhe paraqitet në punë çdo ditë. Nëse vëreni datëlindjen e tij rezulton se ai është në pension. Pagesa e sigurimeve shoqërore që ne i bëjmë nuk i ndikon, i vlen, apo ti japë atij përfitime. Mardhënia financiare midis tij dhe firmës sonë është kontraktuale e korrekte dhe ai është në detyrë çdo ditë. 1. Në lidhje me arsyen se: Mungon certifikata ISO 9001:2015 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të “TERMOSTAHL SOLAR” nga furnizuesi “AL-NBEL” shpk. ju sqarojmë se: Kompania me të cilën kemi lidhur kontratën paraprake, “AL-NOBEL shpk”, është kompani lider në tregun shiptar përsa u përket produkteve të certifikuar që ju i kërkoni në DST. Siç edhe e kemi paraqitur në Dokumentat tona ajo është e certifikuar me standartin ISO 9001-2015 për: Projektim, Instalim, mirëmbajtje dhe SHITJE të impianteve dhe sistemeve për ngrohje-ftohje, hidraulike, ajër kondicionuar, ventilim dhe panele diellore. Kompania greke THERMOSTAHL SOLAR LTD, operon dhe vepron në Greqi, një vend anëtar i Bashkimit Evropian, që sigurisht ka një standart tregu të lartë dhe standartizimin ISO e ka kërkesë përsore. Prodhuesi “THERMOSTAHL SOLAR” ltd, ka qënë në proces rinovimi të certifikates ISO 9001-2015. Çertifikatën e re ISO 9001-2015 po jua vëmë në dispozicion bashkëlidhur këtij dokumenti se bashku me certifikatën e mëparshme 9001-2008.[...]”

II.7. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 709/2 Prot. datë 05.02.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes “Bean” sh.p.k, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.8.Në datën 12.02.2019 operatori ekonomik "Bean" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke shtuar pretendimin si më poshtë vijon:

*"[...]2. Punonjësit e shoqërisë "BEAN" shpk pjesëmarrëse në tender janë të siguruar dhe si rrjedhojë nuk çënon besueshmërinë në realizimin e kontratës. Theksojmë se referuar kriterit të përcaktuar në DST, operatori ekonomik rezulton të ketë më shumë se 80 punonjës të siguruar, kjo është provuar nëpërmjet paraqitjes së vërtetimeve të lëshuara nga Drejtoritë Rajonale Tatimore përkatëse me të dhënat e cdo muaji dhe si rrjedhojë është në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, duke vërtetuar se disponon një numër më të madh se minimumin prej 63 punonjësve të kërkuar nga autoriteti. 3. Ju sqarojmë se formularët e pagave (listëpagesat) janë të strukturuar nga administrata tatimore dhe janë këto instanca të cilët janë kompetente për kontrollin dhe monitorimin e listëpagesave dhe formularëve të pagesave. 4. Ju bëjmë me dije se : Operatori Ekonomik "BEAN" sh.p.k. punonjës i ka siguruar në listëpagesë me ditë pune sipas procesit të punës dhe kohëzgjatjes që ata kryejnë. Nëse një punonjës nuk është siguruar 22 ditë punë, por më pak se aq, kjo do të thotë që ky punonjës kaq ditë ka patur procesin e ngarkuar të punës. Këta punonjës janë pjesë e shoqërive dhe të disponueshëm në cdo kohë ku ka procese pune për të cilat ata janë të kualifikuar. 5. Gjithashtu duam të theksojmë se KVO-ja e autoritetit kontraktor Bashkia Durrës, KA PUNUAR ME DY STANDARTE, pasi gjatë këtyre 6 muajve të fundit shoqërinë "BEAN" sh.p.k. e ka KUALIFIKUAR, me po të njëjtat listëpagesa të kërkuara nga AK, në më shumë se 10 raste. (Bashkëlidhur disa prej formularëve të njoftimit të fituesit nga autoritetit kontraktor Bashkia Durrës , ku tregohet qartë kualifikimi i shoqërisë "BEAN" sh.p.k.)*

II.8.Në datën 27.02.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.4528prot., datë 26.02.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Bean" sh.p.k mbi skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: *"[...]2.Në DST Shtojca 12, pika 2.3 "Për kapacitetin teknik", ne germen k eshte kerkuar si poshte: Kerkohet certificate ISO 9001:2015 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara me poshtë: Kaldaja do të jetë çeliku me kapacitet jo më të vogël se 93kv dhe me dimensione jo më të vogla se 710x1294x1758mm, dalja e oxhakat jo më vogël se Ø 220mm. Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetohet me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit. Operatori ekonomik BEAN per produktin e sipercituar, ka paraqitur nje "Kontrat Furnizimi" te*

dates 28.12.2018, te lidhur midis tij dhe furnizuesit "AL-NOBEL" shpk, me seli ne Tirane, ku ky i fundit me cilesine e distributorit te kompanise TERMOSTAHL SOLAR LTD, deklarone se merr persiper te furnizoje me produktin e sipercituar operatorin ekonomik por, mungon certifikata ISO 9001:2015 e prodhuesit për cilësinë e produkteve. Per arsye te sa me siper u citua, KVO vendos që operatori ekonomik BEAN te mos kualifikohet, pasi nuk përmbush kriteret për kualifikim, te kerkuara ne dokumentat e tenderit. [...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën nr. 12, pika 2.3.k, "Për kapacitetin teknik" në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

*"k.Kerkohet certifikate ISO 9001: 2015 e prodhuesit për cilësinë e produkteve të kërkuara me poshtë:*

*-dritare d/alumini plastike me dopio xham*

*-vetrate d/alumini plastike me dopio xham*

*-Kaldaje çeliku*

*Karakteristikat Teknike :*

*kapaciteti Q= 93kË*

*dalja e oxhakut Ø=220 mm*

*Dimensionet BxLxH 710x1249x1758 mm*

*-F.V pompe qarkullimi binjake INVERTER me karakteristika teknike:*

*prurja 4.06 m<sup>3</sup>/h,*

*prevelanca 80kPa*

*-Ndricues fluoreshent 2x36Ë,IP40*

*-Ndricues projektor me llampe SAP-T 250Ë*

*-F.v Ndricues tavanor 1x40Ë*

*Për produktet e mësipërme, për rastet që operatori ekonomik nuk është prodhues duhet të vërtetojë me marrëveshje bashkëpunimi(ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, ëbsite, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi, si dhe duhet të paraqiten dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) të jenë të përkthyer në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentat e tenderit."*

III.1.2.Nga verifikimi i kryer në SPE, rezulton se në përmbushje të kriterit të sipercituar, lidhur me kaldajën e celikut, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur dokumentacionin si vijon :

1. Kontratë furnizimi nr.2032rep., nr.679/1kol., datë 28.12.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë "Bean" sh.p.k. në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë "Al-Nobel" sh.p.k. në cilësinë e furnizuesit.
2. Certifikatë ISO 9001 : 2015, e shoqërisë "Al-Nobel" sh.p.k.
3. Deklaratë e prodhuesit "Thermostahl Solar", me anë të së cilës autorizohet shoqëria "Al-Nobel" sh.p.k. si distributor i produkteve "Thermostahl Solar" për tregun shqiptar.
4. Katalog i i prodhuesit "Thermostahl Solar".

III.1.3.Në nenin 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.4.Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*

III.1.5.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP vëren se, operatori ekonomik ankimues nuk ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015 për cilësinë e produkteve, të prodhuesit të kaldajës “Thermostahl Solar”, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Prokurimeve, brenda afatit të dorëzimit të ofertave, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar . Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomik do të ofrojnë produktet sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 9001:2015. Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues me mosparaqitjen e certifikatës ISO 9001:2015 të prodhuesit të kaldajës, të kërkuar nga autoriteti kontraktor, nuk garanton këtë të fundit se produkti që do të ofrohet do të jetë sipas standarteve të cilësisë, e për pasojë ndodhemi në kushtet e mospërmbushjes të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor shtojcën nr. 12, pika 2.3.k, “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Komisioni thekson se, operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Referuar legjilacionit në fuqi, nuk

duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

III.1.6. Në rast se operatori ekonomik ankimues “Bean” sh.p.k. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Bean” sh.p.k. nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Bean” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri



### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bean” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt, ”Ndërtim shkolla 9 vjeçare Qerret”, me nr. REF-95528-11-23-2018, me fond limit 74,344,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.01.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 216 protokoli Datë 12.02.2019;**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**